



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1523/2 Prot.

Tiranë, më 14.11.2024

VENDIM

Nr. 17, datë 14/11/2024

PËR

MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR I ASOCIUAR" PRANË KOMISIONIT PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, në nenin 60, pika 3, në nenin 79, pika 7 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 10.03.2021 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë", në Kreun IV, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, në nenin 24 dhe 67 të Statutit të Universitetit të Arteve, si dhe në nenin 17, pika 1 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, të Universitetit të Arteve", pasi i shqyrtoi dosjet dhe diskutoi mbi to,

VENDOSI:

1. Të miratojë përcjelljen e dosjes së **Dr. Manjola Tërshana** për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të UART.
2. Të miratojë përcjelljen e dosjes së **Dr. Marin Gjollma** për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të UART.
3. Të miratojë përcjelljen e dosjes së **Dr. Klevis Gjergji** për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të UART.
4. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
5. Ky vendim të përcillet pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe Fakultetit të Muzikës dhe të publikohet në faqen zyrtare të UART.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)

